



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 669/1 Prot

Tiranë, me 21/7 /2015

Lënda: Mbi projekt-vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” dhe projektligjin “Për shfuqizimin e ligjit nr.8291,datë 25.02.1998 “Kodi i Etikës së Policisë” dhe relacionet shpjeguese përkatëse.

Drejtuar: Z. Saimir TAHIRI
MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

I nderuar z.Tahiri,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.5203/1 Prot, datë 06.07.2015, “Projekt/Rregullorja e Policisë së Shtetit”, vlerësohet e hartuar konform kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Ndërkohë do të vlerësonim përshtatjen e p/aktit me sugjerimet e mëposhtme.

Në shkronjën f) të pikës 5 të nenit 98, togfjalëshi “...me ligjin në zbatim.” të zëvendësohet “...me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Pas pikës 4 të nenit 117 të Rregullores, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje “Punonjësi i policisë/Ai detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë gjatë dhe pas përfundimit të funksionit/detyrës.”

Lidhur me zbatimin e *pikës 6 të nenit 147 të Rregullores* vlerësojmë të rëndësishme evidentimin e masave konkrete për mbrojtjen e të dhënave biometrike. Në rast të krijimit të një sistemi të përpunimit të të dhënave biometrike të përcaktohen dhe merren të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur këto të dhëna, si dhe të parashikohet një regjim rishikimi periodik i sigurisë lidhur me masat e marra apo auditim i sigurisë IT duke trajtuar edhe rrezikun e cënimit të privatësisë.

Pas pikës 4 të nenit 196 të shtohet një pikë me përmbajtje "Punonjësi i policisë gëzon të drejtat e subjektit të të dhënave të parashikuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale".

Pas pikës 2 të nenit 238 të shtohet një pikë me përmbajtje "Afatet e ruajtjes së të dhënave përcaktohen në përputhje me legjislacionin mbi të cilin subjekti i të dhënave ushtron të drejtën e ankimit si dhe zbatohen bazuar në shkronjën d) të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar."

Gjithashtu, mbi projektligjin "Për shfuqizimin e ligjit nr.8291, datë 25.02.1998 "Kodi i Etikës së Policisë" nuk kemi komente apo sugjerime.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

